

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me procesmbajtësen Shyrete Sopaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit M¹ in V² nga ~~V~~³, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren, PP.nr.1330/14 të datës 09.02.2016, për shkak të kryerjes së veprave penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KP-së dhe rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP -së në shqyrtimin fillestar në prezencën e Prokurorit të Shtetit Musli Gashi dhe të akuzuarit, me datë 11.10.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M¹ V², nga i ati M³ dhet dhe e ëma H⁴, e vajzërisë Z⁵, i lindur me ~~1980~~, në fshatin ~~Suharekë~~⁶ komuna e ~~Qënder~~⁷, tani banon në ~~Suharekë~~ rr. "Nëna Terezë" pa.nr. i martuar, baba i pessë fëmijëve, punëtor, ka të kryer shkollën e lartë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës me nr. të ID 101650244.

ËSHTË FAJTOR


I. Se me datën 30.04.2015 rreth orës 15: 10 minuta, në fshatin ~~Malësi e Re~~, me dashje përdor forcën, në atë mënyrë pasi të dëmtuarit ~~Gjemaj Hashani~~ dhe ~~Veli Hoxha~~, shkojnë në lokalin e pandehurit mullirin ~~“KEDS”~~, në cilësinë e punëtorëve të "KEDS" -it, për të kërkuar borxhin që kishte i pandehuri ndaj KEDS -it, i pandehurit fillon të fjaloset e më pas edhe i godet të dëmtuarit, mirëpo nuk ju shkakton lëndime trupore.

Kështu që ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par. 1 të KP-së.

II. Se më datën 15.08.14, rreth orës 08:55 minuta, në rrugën lokale të fshatit ~~Reshtan~~ që lidhet me rrugën e fshatit ~~Fuzati~~, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, duke drejtuar automjetin e markës "Mercedes C 200 CDI", me targa të regjistrimit ~~CF 303-DL~~, vepron në kundërshtim me nenin 72 të LSKRR -së, në atë mënyrë që ndërmerr veprim tejkalimi të motoçikletës, duke mos mbajtur distancën e duhur anësore dhe gjatë tejkalimit me pjesën e përparme të anës së djathtë, e godet në pjesën e pasme motoçikletën të cilën e drejtonte i dëmtuarit ~~Shaban Dëshka~~, ku pos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuarit ~~Shaban Dëshka~~ dhe atë: kontuzion në toraks, komplik, në krahun dhe bërrylin e dorës së majtë.

Kështu që ka kryer veprën penale rrezikim i trafiku publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitiveve të neneve 4, 6, 7, 17, 41, 42, 46, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 62, 73, 80 të KP -së të akuzuarit i shqipton:



DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj për veprën penale nën I. të shqiptimit.

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj për veprën penale nën II. të shqiptimit.

Në kuptim të nenit 80 të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN UNIK

Duke ja vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 2 (dy) vitesh nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Palët e dëmtuara: C~~h~~arri H~~an~~uni, Visar (A~~z~~) H~~an~~uni qe të dy punëtor të "KEDS - it" distrikti në Prizren dhe Bë~~z~~ha (J~~en~~in) Bë~~z~~ha nga Suhareka rr. "Tirana" nr. 29, për realizimin e kërkuesës pasurore udhëzohet në kontestin civil.

I akuzuari, obligohet që t'i paguaj shpenzimet e gjykatës aq sa do të jenë ato sipas llogarisës së arkës së gjykatës për ekspertizën mjekoligjore shumën prej 20 euro, dhe në emër të pashallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm


Arsyetime

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzë PP.nr. 1330/14 të datës 09.02.2016, kundër të akuzuarit M~~u~~si V~~eli~~ngi për shkak të veprave penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar më dt. 11.10.2017 në prezencën e prokurorit dhe të akuzuarit. Është lexuar aktakuza nga ana e Prokurorit të Shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provat materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroj se ka kuptuar aktakuzën dhe e pranojë fajësinë dhe pranueshmërinë e provave, duke deklaruar se i vije keq për veprat që i ka kryer dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla.

Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I. Se me datën 30.04.2015 rreth orës 15: 10 minuta, në fshatin Malësi e Re, me dashje përdor forcën, në atë mënyrë pasi të dëmtuarit Gj~~om~~al H~~an~~uni dhe Visar H~~an~~uni, shkojnë në lokalin e të pandehurit mullirin "valoni", në cilësinë e punëtorëve të "KEDS" -it, për të kërkuar borxhin që kishte i pandehuri ndaj KEDS -it, i pandehurit fillon të fjaloset e më pas edhe i godet të dëmtuarit, mirëpo nuk ju shkakton lëndime trupore.



II. Se më datën 15.08.14, rrreth orës 08:55 minuta, në rrugën lokale të fshatit ~~Shushan~~ që lidhet me rrugën e fshatit ~~Pecaj~~, nga pakujdesia rezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, duke drejtuar automjetin e markës "Mercedes C 200 CDI", me targa të regjistrimit ~~04-08-11~~, vpron në kundërshtim me nenin 72 të LSKRR -së, në atë mënyrë që ndërmerr veprim tejkalimi të motoçikletës, duke mos mbajtur distancën e duhur anësore dhe gjatë tejkalimit me pjesën e përparme të anës së djathët, e godet në pjesën e pasme motoçikletën të cilën e drejtonte i dëmtuarit ~~Besim Basha~~, ku pos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuarit ~~Besim Basha~~ dhe atë: kontuzion në toraks, komplik, në krahun dhe bërrylin e dorës së majtë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, për veprat penale, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat, gjyqtari konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër, dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në vendimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruara si në shqiptime të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësinë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, se është kyefamiljar, se në gjykim ka patur qëndrim korrekt, pranimi i fajësisë, nuk ka qenë i dënuar më parë. Kështu si rrethana rënduese ka vlerësuar peshën e veprave penale dhe mënyrën e kryerjes andaj ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga nenit 41 i KP-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcione me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për kërkesën pasurore juridike në kontest civil, është marrë konfrom nenit 463 par. 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 451 par.1 dhe 453 par. 1 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.303/16, me datë 11.10.2017

Procesmbajtësja
Shyhrete Sopaj



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të nejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.